



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec

-III- Nr. I prot  
Br. prot.

1963

Më  
Dl.

24.06.2024

RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L222 dhe Ligji Nr. 04/L-116 nenin 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 5,7 dhe 8 të rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Nr. 1427, e datës 28.4.2017, dispozitat e nenit 8, 10, 12 dhe 16 të Rregullores MF-Nr, 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 74, dhe nenit 92, paragrafi 4 të statutit të Komunës, Nr 1005, i datës 29.3.2017 dhe Thirrjes Publike të datës 31.5.2024, me numër protokolli 1776, mbi organizimin e festave tradicionale kulturore në Komunën e Rahovecit, të cilat janë: Festa e vjeljes së rrushit 7 shtatori – HardhFest dhe Agrofesta, bazuar në vendimin 4346/138 të datës 19.6.2024 për formimin e Komisionit, për shqyrtimin dhe vlerësimin e Aplikacioneve për ndarje të Subvencioneve për OJQ-të, mbi bazën e thirrjes publike, Komisioni Vlerësues, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Në përputhje me afatet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues, të përcaktuara me Rregulloren e Lartcekur dhe vendimit të Kryetarit të Komunës dhe mbi bazën e thirrjes Publike të datës 31.5.2024, komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjitha aplikacionet dhe dokumentacionin përkatës të dërguar nga OJQ-të, ku sipas kriterëve, Komisioni Vlerësues, ka shpallur fitues për Subvencionim, këtë OJQ:

2.

| Numri | Emrat e OJQ-ve     | Shuma       |
|-------|--------------------|-------------|
| 1     | SHOQATA HARDH FEST | 50,000.00 € |

3. Pas kalimit të afatit të ankesave dhe të procedurave të tjera të parapara në rregulloret e lartcekura, Kryetari i Komunës, do të lidh kontratat me përfituesit e mjeteve financiare me të gjitha OJQ-të përfituese.

## ARSYETIM

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të, mbi bazën e thirrjes publike dhe në përputhje me Rregulloret e lartcekura, ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni dhe mbi bazën e thirrjes publike nga një (1) aplikacion, kriteret i ka plotësuar vetëm një OJQ. Në përputhje me detyrat, përgjegjësitë dhe afatet e komisionit, të përcaktuara në Rregulloren e lartcekur dhe duke vlerësuar secilin aplikacion dhe projekt të OJQ-ve, veç e veç, sipas thirrjes publike të datës 31.5.2024.

Nga sa u tha më lart, Komisioni ka vendosur sipas vendimit.

**Udhëzim Juridik:** kundër këtij vendimi lejohet ankesë në afat prej 5 ditësh, në komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave të OJQ-ve në Komunën e Rahovecit.

Datë: 24.6.2024

Anëtarët e Komisionit:

- 1.1. Egzon Thaqi, kryesues
- 1.2. Diellza Çanta, anëtare
- 1.3. Fidan Hoti, anëtar
- 1.4. Bahrije Qmega, anëtare
- 1.5. Nazmi Bellaqa, anëtar nga Shoqëria Civile

